

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 619 Nr. i faq./Br.str./No pg 155

Data/Datum/Date 22 / 5 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC



KOMUNA E RAHOVECIT
OPŠTINA ORAHOVAC - MUNICIPALITY OF RAHOVEC

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DREJTORIA E GJEODEZISË, KADASTRIT DHE PRONËS

PRILL 2023



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (AQP), në komunën e Rahovecit përkatësisht në Drejtorinë e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit (DPGJK) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), ka identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-a-vis* legjislacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimit është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengoj gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Rahovecit me mbështetje nga AQP, ka realizuar një punëtori dy ditore më 24-25 Prill 2023, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Rahovecit dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastër, Grupi II-Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DPGJK.

Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

AQP në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Rahovecit në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DPGJK Rahovec, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrit Civil
QeK	Qeveria e Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
LK	Ligji për Kadastër
LKPP	Projektligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
LRDPPs	Ligji për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PGA	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
SIKTK	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
SIK	Sistemi i Intranetit të Komunës
ZIP	Zyra për Informim të Publikut
DPGJK	Zyra Kadastrale e Komunës
ZKM	Zyra e Kryeministrit

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA RAHOVEC

PJESA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
		1.1	Barja e shërbimit të kopjes së planit nga zyra kryesore (e punës) tek zyra pritëse (sporteli)	Vendimi i Drejtorit të DPGJK-së	DPGJK	Nuk ka	Maj 2023	Nuk parashihen rreziqe
		1.2	Zyra pritëse të jetë e veçantë dhe e ndarë nga shërbimet tjera komunale	Kërkesa nga Drejtori i DPGJK-së tek Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Kryetarit	DPGJK, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Kryetarit	3,000 euro	Kërkesa në Maj 2023, finalizimi në Qershor 2023.	Hapësira e vogël për të ndarë zyrë të veçantë
		1.3	Të riorganizohet puna me palë, me orar të caktuar 2-3 ditë në javë dhe pajisja me inventar adekuat për punë me palë	Vendimi i Drejtorit të DPGJK-së	DPGJK	Nuk ka	Tetor 2023	Pa mundësi të lidhjes së kontratës për inventar
		1.4	Salla e Kuvendit të dedikohet për zyrë të drejtorive të Komunes, ndërsa Salla e re e kuvendit të ndërtohet si aneks i objektit të komunës	Kërkesa nga Drejtori i Administratës tek Zyra e Kryetarit	Drejtorja e Administratës dhe Zyra e Kryetarit	200,000 euro	Kërkesa gjatë vitit 2023. Realizimi i kërkesës 2 vite pas aprovimit të kërkesës	Mungesa e fondeve
		1.5	E-kiosk me pëmbajtje të produkteve nga E-Kosova	Kërkesa nga Drejtori i Administratës tek Zyra e Kryetarit	Drejtorja e Administratës dhe Zyra e Kryetarit	1,000 euro	Maj 2023	Nuk parashihen rreziqe

Krijimi i zyrës pritëse në katin përdhësë

		Ri-sistemimi dhe organizimi i Arkivës, me vendim nga Drejtori i DPGJK-së	DPGJK	Nuk ka	Korrik 2023	Nuk parashihen rreziqe
	1.6	Ri-sistemimi i Arkivës së Kadastrit dhe blerja e inventarit, që të krijohet hapësirë shesë	DPGJK, Drejtorja e Administratës dhe Zyra e Kryetarit	2.000 euro	Nëntor 2023	blungesa e fondëve
2	2	Blerja e 1 skaneri	DPGJK dhe Drejtorja e Administratës	1.300 euro	Maj 2023	Nuk parashihen rreziqe
3	3	Ri-organizimi në mos të sektoreve të Gjeodezisë dhe Kadastrit	DPGJK, Drejtorja e Administratës, Zyra e Personelit dhe Zyra e Kryetarit	Nuk ka	Qershor 2024	Nuk parashihen rreziqe
4	4.1	Kërkesa tek AKK për mundësi e kalkulimit të koordinatave me softuer të veçantë apo format Excel që tu ofrohet gjeodetëve të licencuar për kalkulim	Kërkesa e Drejtorit të DPGJK-së në AKK apo në ndonjë komunë që përdor të njëjtin sistem si p.sh. Komuna e Pejës	Nuk ka	Kërkesa në Maj 2023, ndërsa realizimi deni në Gusht	Pa mundësi e krijimit të sistemit
	4.2	Trajnimi i gjeodetëve të licencuar për kalkulim të koordinatave	Trajnimi nga AKK	2.000 euro	Shator 2023	Nuk parashihen rreziqe

			Kërkesa e Drejtorit të DPGJK-së tek Zyra e Kryetarit	DPGJK dhe Zyra e Kryetarit	10,000 euro	Gjatë vitit 2024	Mungesa e fondeve
	4.3	Pilot projekt në një pjesë të Zonës Kadastrale Rahovec për kalkulimit të koordinatave	Kërkesa e Drejtorit të DPGJK-së në AKK	DPGJK dhe AKK	10,000 euro	Gjatë vitit 2024	Mungesa e fondeve
	4.4	Konsulencë në përpilimin e Termave të Referencës	Kërkesa e Drejtorit të DPGJK-së në AKK	DPGJK dhe AKK	Nuk ka	Gjatë vitit 2024	Nuk parashihen rezige
	4.5	Projekt për kalkulimit të koordinatave	Kërkesa e Drejtorit të DPGJK-së tek Zyra e Kryetarit apo në AKK	DPGJK dhe Zyra e Kryetarit (apo AKK)	20,000-30,000 euro	Pas përfundimit të pilot projektit	Mungesa e fondeve
5	5	Projekt i sipas pikës 4	Kërkesa e Drejtorit të DPGJK-së tek Zyra e Kryetarit apo në AKK	DPGJK dhe Zyra e Kryetarit (apo AKK)	20,000-30,000 euro	Pas përfundimit të pilot projektit	Mungesa e fondeve
		Vonesat eventuale në lëndë					

PJESA LIGJORE							
Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUGJETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZQET DHE SFIDAT
1	Nuk ka një mekanizëm brenda në Komunë për rishqyrtimin e vendimeve të DPGJK-ve për refuzim të kërkesës për regjistrimin e të drejtave pronësore në SIKTK.	Te rastet e kërkesave për rishqyrtimin e vendimit të DPGJK-së. Drejtori i DPGJK-së të sigurohet që personi i kërkesave mos të jetë zyrtari i njëjtë i cili o ka refuzuar kërkesën për regjistrim fillestar, në mënyrë që të shmangët konfliktin i interesit dhe të sigurohet gjykimi i drejtë për personat fizik dhe juridik. Rekomandohet që të buxhetohet për vitin 2024 punësimi edhe për 1 zyrtarë shtesë (jurist) në DPGJK.	Te planifikohet buxheti për vitin 2024 edhe për 1 zyrtarë shtesë (jurist) në DSHPJK	DPGJK, Zyra e Personelit	6,930 Euro	Gjatë vitit 2023 Në fillim të vitit 2024	Mos aprovimi i buxheut për zyrtar shtesë ose deshimi i procedurës së rekrutimit të stafit të ri
2	Afatet kohore janë të përcaktuara qartë në dispozitat e LK-së dhe LRDPP-së (deri 120 ditë në total). DPGJK-ja në disa raste nuk i informon parashtruesit e kërkesave për shkresat jo të plota në kërkesë dhe nuk kërkon dorëzimin e dokumenteve që mungojnë brenda 15 ditëve nga pranimi i kërkesës, siç kërkohej me ligj. Si rezultat disa parashtrues të kërkesave kanë pritur deri në një vit vendimin nëse do t'u pranohet apo refuzohet kërkesa e tyre.	Komuna duhet të respektoj afatet e parapara ligjore të përcaktuara në LK dhe LRDPP.	Të planifikohet buxheti për vitin 2024 edhe për 1 zyrtarë shtesë (jurist) në DPGJK	DPGJK, DAP dhe Zyra e Personelit	6,930 Euro në vit	Maj 2023	Nëse nuk inicohet kërkesa për staf shtesë
			Të zhvillohen procedurat e rekrutimit sipas legjislacionit në fuqi	DPGJK, DAP dhe Zyra e Personelit	6,930 Euro në total	Gjatë vitit 2024	Nëse nuk aprovohet staf shtesë
			Trajnimi i zyrtarëve të ri për procedurat për shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim të vendimeve të DPGJK-së	DPGJK dhe AKK	Nuk ka implikime buxhetore	Trajnimet do të mbahen në pjesën e parë të vitit 2024	Nuk ka
			Hapësira të veçanta (të ndara) për jurist që punojnë në DPGJK me kërkesa për regjistrim të drejtave pronësore	DPGJK, DAP	Mbetet për tu konfirmuar	Fillimi i vitit 2024	Nëse nuk sigurohet hapësira nga Komuna

3	LRDPP përcakton që çdo DPGJK të mbajë tabelën e shpalljeve publike ku afshohen njoftimet e kërkesave për regjistrim për të paktën pesë ditë pune përpara nxjerrjes së vendimit që lejton regjistrimin. Njoftimi duhet të përmbajë: adresën e pronës, dhe nëse është e mundur, numrin e parcelës kadastrale; të dhënat për personin prej të cilit bëhet barëja e të drejtës mbi pronën; të dhënat për personin që me regjistrim e fiton të drejtën mbi pronën; të drejtën që duhet të regjistrohet; dhe datën deri kur çdo palë e interesuar mund të paraqitë kundërshtimin të DPGJK. DPGJK në disa raste nuk e afshon këtë njoftim në tabelën e shpalljeve publike, siç kërkohej me ligj.	DPGJK duhet ta miremëbajë tabelën e shpalljeve publike dhe t'i afshoj njoftimet e kërkesave për regjistrim për të paktën pesë ditë pune përpara nxjerrjes së vendimit që lejton regjistrimin.	Vendosjen e afshëve në vendin paracaktuar për shpallje publike, në momentin që printohen nga sistemi SIKTK i AKK-së	Shefi i Sektorit të Kadastrit/ Drejtori i DPGJK-së	Nuk ka	Gjatë tërë kohës duke filluar nga Qershoi 2023	Nuk ka
4	Neni 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës përfshijnë gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe dhe secila kanë status të barabartë. Neni 7 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve detyron institucionet komunale që të mbajnë regjistra publike dhe të lëshojnë dokumente zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare. DPGJK-ja në njoftime dhe vendime vetëm në gjuhën shqipe.	Komuna duhet të respektojë dispozitat e ligjit dhe të publikojë njoftimet jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhën serbe.	Buxhelimi i një zyrtari për përkthime në gjuhën serbo-kroate	Drejtori i DPGJK-së, Drejtori i DAP-së	6,930 Euro në vit	Janar 2024	Nëse nuk buxhelohet pozita, ose nëse dështon procedura e rekrutimit

PËRFSHIRJE GJINORE DHE SOCIALE

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore. Te shqyrtohen masa të tjera afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.	Zyrtaret komunalë për çështje gjinore duhet të pajisen me mjete të duhura financiare dhe logjistike për të ofruar trajnime/punëtori informative në zonat rurale për të drejtat e regjistrimit të pasurisë së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve.	Organizimi i fushatave sensibilizuese me qytetarët, me fokus grupe nga viset rurale, duke përfshirë fushata edhe materiale informuese: ligjërata, vizitat, shpërndarja e materialeve/informjeteve informuese, diskutimi me OJQ-të, biznese.	Zyra për Barazinë Gjinore, Zyra e Kryetarit, Zyra për Informim.	Ka implikime buxhetore për organizimin e fushatave vetëdijësuese (përgatitja e fletushkave, broshurave, etj.) vizitave në terren.	Gjysma e dytë e viteve 2023-2027	Mungesa e buxhetit për organizimin e aktiviteteve të tilla si: fushata të informuese, resurseve njerëzore të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve.
2	Zbatimi i masave mbrojtëse të parapara me Ligjin për Trashëgiminë dhe Ligjin për Procedurën Jokontestimore do t'i fuqizojë gratë në procedurat dhe proceset e trashëgimisë.	Zyrtarët e Gjendjes Civile t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë dhe Ligjit për Procedurën Jokontestimore gjatë nxjerrjes së akteve të vdekjes sipas detyrës zyrtare dhe ta eliminojnë përjashtimin e mundshëm të grave nga trashëgimia si rezultat i mos deklarimit në trashëgimi, përmes programit të gjendjes civile i cili duhet të ketë trungun familjar.	Trajnimi i zyrtarëve të gjendjes civile për nxjerrjen e akteve të vdekjes dhe trungun familjar. Fushatë vetëdijësuese periodike për qytetarët për mënyrën e nxjerrjes së aktit të vdekjes.	Drejtoria për Administratë (Zyrtarët e Gjendjes Civile)	Buxhet për trajnim të zyrtarëve të gjendjes civile. Buxhet për fushatë vetëdijësuese periodike.	Përgatitja për implementim gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, ndërsa implementimi të filloj nga fillimi i 2024.	Mungesa e buxhetit për organizimin e aktiviteteve.
3	Duhet të krijohen masa dhe të ndërmerren veprime të veçanta për mbështetjen e grave për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal.	Krijimi i një fondi komunal të përbashkët për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja.	Cdo vit kalendarik, KK ta miratohet plani komunal si pjesë integrale e planifikimit buxhetor vjetor.	Kuvendi Komunal, Drejtoria e Bujqësisë dhe e Ekonomisë.	Cdo vit kalendarik ndahet buxhet për subvencione dhe grante. Buxhet për sesione informuese për ngjarjen e kapaciteteve të grave për aplikim për subvencione dhe grante.	Cdo vit kalendarik, aprovim të kodit të veçantë nga Ministria e Financave për kategorinë e subvencioneve dhe granteve.	Mungesa e vullnetit politik. Mungesa e aproimit të kodit të veçantë nga Ministria e Financave për kategorinë e subvencioneve dhe granteve.

Personat me nevoja të veçantë kanë njohuri shumë elementare mbi komizën legjislative për të drejtat pronësore. Personat me nevoja të veçanta nuk kanë njohuri për procedurat dhe proceset e regjistrimit të pronës. Grupet e cënueshme nuk kanë qasje në objekt dhe informacione rreth shërbimeve të pronës.

5

Krijimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta për qasje në institucione komunale.

Komuna të angazhohet për sigurimin e pajisjeve (komputerit me alfabetin e Brajlit), interpret për gjuhën e shenjaive, shiritat për ecje për persona me të pamur të dëmtuar, ofrimi i qasjes fizike për personat në karrocë.

Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Geodezi, Kadaster dhe Pronë, Drejtoria e Urbanizimit, QPS-ja, Drejtoria e Shëndetësisë, Njësia për të Drejtat e Mjeriut, Grupin e Grave, Asambleiste.

Organizimi i punëtorëve me përfaqësuesit e OJQ-ve nga fusha e nevojave të veçanta për të identifikuar saktësisht nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohet kjo kategori. Të organizohen fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë

Të ngritet vetëdija për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë për këtë kategori.

Buxhet për organizimin e punëtorëve për identifikim e nevojave për persona me nevoja të veçanta.

Buxhet të ndarë për krijimin e qasjes fizike të personave në karrocë në ndërtesën e komunës (pjerina, asensor special, hapësira të veçanta për të marrë shërbimet); buxhet i ndarë për funksionalizimin e alfabetit të Brajlit (komputer special), për interpret të gjuhës së shenjaive, për shenjëzimin e shtegut për persona me të pamur të dëmtuar.

Organizimi i punëtorëve për identifikim të nevojave të filloj në vitin 2024. Nga gjysma e dytë e vitit 2023 të fillojnë përgatitjet për përtshirje në planifikim të buxhetit për vitin 2024, çështjet që lidhen me rregullimin e infrastrukturës fizike për qasje për persona me nevoja të veçanta.

Kosloja e lartë dhe murgesa e buxhetit; murgesa e hapësirës në komunë për ndryshime për qasje fizike;